



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

30.06.2023

Organi	Numri	Titulli	Viteti
Org. broj	Num. Vjetor	Reling	Vend. Nr.

01-110/05-889



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe neni 40, paragrafi 40.2, pika d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neni 35, paragrafi 35.2, pika d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 30.06.2023, merr këtë:

V E N D I M

për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2024

Neni 1

Me këtë Vendim, Kuvendi Komunal i Vitisë MIRATON vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2024.

Komisioni përbëhet nga këta anëtar:

1. Bekim Azizi Kryesuesi i Kuvendit Komunal
2. Ali Bajrami GP- të LDK-së
3. Majlinda Shabani GP- të VV-së
4. Anisë Zejnullahu GP- të PDK-së
5. Reshat Azizi Këshilltar komunal nga AAK-së
6. Fatlum Demiri Sekretaria e Kuvendit
7. Melihate Osmani Përfaqësues nga shoqëria civile

Neni 2

Grupi punues konform nenit 1 të këtij propozim vendimi, në konsultim me kryetarin e Komunës, drejtorët e Drejtorive komunale, subjektet politike të përfaqësuar në Kuvend dhe shoqërinë civile, harton Draftin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin kalendarik 2024 dhe të njëjtin e paraqet para Kuvendit të Komunës për miratim.

Neni 3.

Plani vjetor i punës së Kuvendit duhet të përmbajë: objektivat dhe qëllimet e kuvendit, aktivitetet e planifikuara të Kuvendit dhe Komiteteve obligative dhe funksionale të Kuvendit, afatet e përmbushjes dhe realizimin e aktiviteteve të parapara.

Neni 4.

Plani i punës së Kuvendit mund të ndryshohet dhe plotësohet nga ana e Kuvendit sa herë që kjo të jetë e nevojshme.

Neni 5

Për zbatimin e këtij propozim vendimi kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Dorëzohet:

1. Kryesuesit të Kuvendit;
2. Anëtarëve të grupit punues; dhe
3. Arkivit.

KRYESUESI I KUVENDIT
Bekim Azizi